

VENDIM
Nr. 45, datë 15.3.2019

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 18, datë 18.2.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/4 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 93/2 prot., datë 20.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, dhe bëri me dije mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.

- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes se komenteve dhe opinionëve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë aplikim.

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93/3, datë 4.3.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi